

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga **SALUS, tregtia me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera d.d.**, rruga Litostrojska 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes avokates Andrea Lazarevska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.07.2023, solli

#### AKTVENDIM

Vërtetohet përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit nga **SALUS, tregtia me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera d.d.**, rruga Litostrojska 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni mbi **Medorion d.o.o. për shërbime, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**, Rruga Janka Drashkoviqa 5, 10430 Samobor, Republika e Kroacisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksa administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

#### Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 20.06.2023, plotësuar më 27.06.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga **SALUS, tregtia me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera d.d.**, rruga Litostrojska 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni, ku **SALUS, tregtia me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera d.d.**, do të fitoj kontroll të vetëm mbi **Medorion d.o.o. për shërbime, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**, Rruga Janka Drashkoviqa 5, 10430 Samobor, Republika e Kroacisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

**Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**SALUS, tregtia me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera d.d.(SALUS)** është kompania mëmë e Grupit të Kompanive Salus ("Grupi Salus "). Grupi Salus gjeneron shumicën e të ardhurave të tij nëpërmjet ndërmarrjeve bijë të tij SALUS dhe Sanolejbor d.d. ("Sanolejbor"), aktivitetet kryesore të të cilit janë tregtia me shumicë (Salus dhe Sanolejbor) dhe tregtia me pakicë (Sanolejbor) e barnave, produkteve farmaceutike, ndihmave mjekësore, pajisjeve dhe materialeve mjekësore. Shoqëritë brenda Grupit Salus ofrojnë gjithashtu shërbime magazinimi, rregullatorë, shërbime farmakovigilence, marketing dhe promovim farmaceutik, farmakoekonomi.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Salus është aktiv përmes ndërmarrjes bijë të tij CARSO PHARM, shpknj Ilinden, që është aktive në përfaqësimin dhe tregtimin e markave tregtare të prodhuesve kryesorë të produkteve farmaceutike.

**Medorion d.o.o.** është aktive në shpërndarjen e barnave për sëmundje të rralla dhe ka arritur vetëm qarkullim të parëndësishëm në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 nga shitja tek klientët e saj në Maqedoninë e Veriut. Medorion nuk ka asnjë pasuri në Maqedoninë e Veriut. Aktivitetet e tij në Maqedoninë e Veriut janë kryesisht të përqendruara në hulumtimin e tregut, krijimin e vetëdijes për sëmundjet e rralla dhe produktet në dispozicion, si dhe edukimin e punonjësve të kujdesit shëndetësor në temën e sëmundjeve të rralla. Medorion nuk ka një rrjet shpërndarës në Maqedoninë e Veriut, qarkullimi i tij krijohet nga shitja e rastësishme tek një klient i vetëm.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**